

## AKT THEMELIMI

### SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### "ALBA BUSINESS" SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

- Z. ELINA MOLINO LESINA, shtetase Italiane, e datëlindjes 11/09/1956, lindur në Itali, Trivero (VC), banues në Shqiperi, Tirane, Rruga: Frang Bardhi, Pallati 6/381, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pashaportes me nr. YA6420761
- Z. FEDERICO LOZIA, shtetas Italian, datëlindjes 09/10/1963, lindur në Itali, Biell (VC), banues në Shqiperi, Tirane, Rruga: Frang Bardhi, Apartamenti 43, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pashaportes me nr. YA6420812

#### *Pjesa e përgjithshme*

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", sot me datë 19/12/2022 hartojnë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

#### NENI 1

#### *Emri*

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin "**ALBA BUSINESS" SH.P.K.** Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

#### NENI 2

#### *Forma*

Shoqëria tregtare "**ALBA BUSINESS" SH.P.K.**, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

#### NENI 3

#### *Zyra Qëndrore*

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**ALBA BUSINESS SH.P.K.**", do të ketë zyrën e saj qëndrore ne: Durres, Lagjja nr.3, Sheshi Liria, Kati I trete, Zone Kadastrale 8514, objekt me Nr. Pasurie 3/319.

3.2 Ndryshimi i zyrës qëndrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

#### NENI 4

### *Objekti i veprimtarisë*

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Konsulencë për çështje financiare, administrative, organizative dhe rregullatore. Kontraktimi i shërbimeve në çështjet financiare, administrative, organizative dhe rregullatore. Kompania gjithashtu mund të blejë dhe/ose të administrojë çdo lloj aktivi/vlere të luajtshme ose të paluajtshme, të marrë dhe të japë hua. E gjithë kjo në Shqipëri dhe jashtë saj, me kusht që të jetë në përputhje me rregullat në fuqi.

### NENI 5

#### *Kohëzgjatja*

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë pa afat.

### NENI6

#### *Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit*

Shoqëria tregtare "ALBA BUSINESS" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

### NENI 7

#### *Përgjegjësiqë e Ortakëve*

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimin e shoqërisë "ALBA BUSINESS" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

### NENI 8

#### *Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat*

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ALBA BUSINESS" SHPK është 1.000 (një mijë) Euro, e konvertuar ne monedhen Leke ne vleren 120.000 (njeqind e njezet mijë) Leke, e ndarë në 2 kuota, e cila është nënshkruar rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Z. – **ELINA MOLINO LESINA** është ortaku i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, të barabartë me 49% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 58.800 leke.
- Z. – **FEDERICO LOZIA** është ortaku i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, të barabartë me 51% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 61.200 leke.

### NENI 9

### *Organet e shoqërisë*

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcione pjesëmarrjen e tyre në kapital.

### **NENI 10**

#### *Administratori*

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë do te jete:

- Z. ELINA MOLINO LESINA, e bija e Ermes, shtetase Italiane, e datëlindjes 11/09/1956, lindur në Itali, Trivero (VC), banuese në Shqiperi, Tirane, Rruga: Frang Bardhi, Pallati 6/381, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pashaportes me nr. YA6420761

### **NENI 11**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

*Ky Akt-Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinalë në gjuhën shqipe.*


### **ORTAKËT THEMELUES**

Z. Federico Lozia



Z. Elina Molino Lesina

ELINA MOLINO LESINA



DURRES 19/12/2022

